



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH

Nr. 1552 Prot.

Elbasan më 25 / 12 / 2014

### KONTRATE KOLAUDIM PUNIMESH

Kolaudimi per objektin «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH

Sot me date 25/12/2014, ne Komunen Kodovjat, Gramsh, duke u mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve, ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar), neni 58, VKM nr.914 date 29.12.2014 "Miratimi i Rregullave te prokurimit Publik" ( i ndryshuar ) kreu VII, neni 70, Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" ( i ndryshuar ), neni 7 dhe VKM Nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit" (I ndryshuar), kreu I, per kryerjen e sherbimit te " Kolaudimit per objektin : «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH, sipas kushteve te meposhteme:

#### **KREU I: KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne ato te Kushteve te veçanta te kontrates.

#### **Neni 1 Përkufizime**

Autoriteti Kontraktor është **Komuna Kodovjat**, me adrese Gramsh, perfaqesuar nga Kryetari i Komunes z.Aranit Cela, me poshte i referuar si AUTORITETI KONTRAKTOR (Autoriteti Kontraktor që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate **blen sherbime**),

Kontraktuesi është **Operatori Ekonomik, Person Fizik ing. Hekuran Xhina**, me adrese Lagja.11 Nentori Elbasan, me licence profesionale nr.MK.1245/2 dhe regjistruar ne QKR me date 09/09/2002 me NIPT-K32625210S perfaqesuar nga administratori Z.Hekuran Xhina, me poshte i referuar si KONTRAKTUESI (personi fizik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate **shet sherbime**),

#### **Neni 2 Objekti i Kontrates**

Person Fizik **Hekuran Xhina** do te kryeje detyren e kolaudimin e punimeve ne objektin: «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH te Autoritetit



**Kontraktor, caktuar ne baze te ofertave te dates 22/12/.2014, nga autoriteti kontraktor Komuna Kodovjat. Kjo detyre ka per qellim kontrollin e mbarevajtjes se te gjithë procesit te kolaudimit te punimeve ne perputhje me projektin, kushtet teknike te projektimit, te zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh cilesine e tij.**

**Person Fizik Hekuran Xhina** perfaqesuar nga ing.Hekuran Xhina, ne cilesine e kolaudatorit te punimeve, eshte pergjegjes per saktesine, vertetesine e dokumentave dhe cilesine e punimeve te ndertimit, ne objektin ne fjale. Ky sherbim do te jete ne cilesi dhe sasi sikurse eshte percaktuar ne dokumentat e prokurimit dhe pranuar ne dokumentacionin e ofertes te paraqitur nga Kontraktuesi.

### **Neni 3: Vlefta Kontrates.**

**Vlera e Sherbimit :** Kolaudimi i Objektit: «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» **KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH**, eshte :

**-Pa tvsh 8333 (Tetemije e treqind e tridhjetë e tre) lek**

**- Me tvsh 10000(Dhjetë mijë) lek**

Vlera eshte percaktuar ne dokumentacionin e ofertes te paraqitur nga kontraktuesi Person Fizik Hekuran Xhina.

**Cmimi i parashikuar me siper perfshin te gjitha shpenzimet e kontraktuesit per sherbimin Kolaudimi i Objektit: «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH si dhe te gjitha detyrimet fiskale ne fuqi. Autoriteti Kontraktor pergjigjet financiarisht ndaj kontraktuesit vetem per ndryshimin zyrtar te detyrimeve fiskale te Kontraktuesit gjate periudhes se vlefshmerise se kontrates.**

### **Neni 4: Kushtet e Pagesës**

Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

Pagesa e çmimit te kesaj kontrate do te behet nga Autoriteti Kontraktor, ne monedhen leke nepermjet bankes BKT Elbasan.

Pagesa do ti behet Kontraktuesit brenda 30 ditëve nga data e arritjes së marreveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë e cila do që të jetë më vonë. Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Kur data e mesiperme eshte dite pushimi zyrtar, pagesa do te behet ditën pasardhese te punes.

Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

### **Neni 5: Fillimi i Kontrates**

Afati i kryerjes se sherbimit objekt kontrate, nga Kontraktuesi do te jete nga **data 25.12.2014 deri me date 29.12.2014** kjo sipas kerkesave te autoritetit kontrator te percaktuara e te pranuar nga operatori ekonomik Person **Fizik Hekuran Xhina**.

### **Neni 6: Vendndodhja e Shërbimeve**



**Kontraktuesi do te kryerje Sherbimin, Kolaudimi i Objektit «Kanalizimi I Ujrave te zeza Fshati Bulçar» KOMUNA KODOVJAT, GRAMSH**

**Neni 7: Detyrimet e Kontraktuesit**

7.1. Kolodatori mban dhe pergjigjet per dokumentacionin e percaktuar ne pikat a, b, c, ç, d te nenit 4 te VKM Nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", kreu I.

7.2. Ne castin e kontrollit duhet te beje veprimet paraprake te percaktuara ne pikat a, b, c, ç, te nenit 5 te VKM Nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", kreu I.

7.3. Materialet e perdorura ne objekt, duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit . bashku me aktin teknik ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare dhe atyre europiane.

**Neni 8: Detyrimet e Autoritetit Kontraktor.**

Autoriteti Kontraktor detyrohet, ne zbatim te kesaj kontrate:

1. T'i paguaje Kontraktuesit vleren e kontrates, sipas percaktimit te bere ne nenin 3.
2. Te njoftoje me shkrim Kontraktuesin per venndodhjen e objektit te sherbimit .

**Neni 9: Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale**

Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të siguroje Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale.

**Neni 10: Kushte te tjera.**

Marrja e detyres nga koludatori do te behet me proces-verbal te nenshkruar nga te dy palet kontraktuese.

**Neni 11: Ndryshimet dhe prishja e kontrates**

1. Palet mund te bejne ndryshime ne permbajtjen e kontrates me pelqim te te dy paleve me shkrim, kur nje gje e tille nuk ndalohet nga dispozitat ligjore ne fuqi.
2. Kur Kontraktuesi terhiqet nga kontrata ai do te shlyeje te gjitha detyrimet qe kane lindur nga realizimi i pjeseshem i saj.
3. Ne rast se Autoriteti Kontraktor terhiqet nga kontrata Kontraktuesi mund te kerkoje demshperblim vetem per ate pjese te realizuar te kontrates.
4. Sejcila nga palet mund te prishe kontraten, pa patur pergjegjesi financiare, nese pala tjetere shkakton nje shkelje themelore te kontrates. Shkelje te tilla per efekt te kesaj kontrate jane:


-Kur kryhen vjedhje dhe kjo nuk raportohet nga Kontraktuesi menjehere.

-Kur cilesia e sherbimit nga Kontraktuesi nuk i permbush kushtet e kontrates, si dhe kur nuk permbushen rregullat e etikes per nje institucion shteteror.

-Kur demti i shkaktuar nuk çdemtohet nga Kontraktuesi, pas njoftimit me shkrim te Autoritetit Kontraktor .

**Neni 12 Lajmërimet**

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.



### **Neni 13 Llogaritja e Afateve**

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

### **Neni 14: Dispozita te fundit**

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te saj nga palet.  
Mosmarreveshjet midis paleve do te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert per zgjidhjen e tyre palet do ti drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

**PER AUTORITETIN KONTRAKTOR**

**Komuna Kodovjat  
Kryetari  
Aranit Cela**



**PER KONTRAKTUESIN**

**Person Fizik  
Hekuran Xhina**

